



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHITETIT

**N J O F T I M**

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË NË TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË SPECIALIZIMEVE  
AFATGJATA TË CIKLIT TË TRETË NË FUSHËN E MJEKËSISË DHE STOMATOLOGJISË**

Për të gjithë kandidatët aplikantë në testimin e informatizuar të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e Mjekësisë dhe Stomatologjisë, ju bëjmë me dije se testimi do të zhvillohet në datat **29 dhe 30 Prill 2024**, në mesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish ATSH).

Kalendari dhe listat emërore me orarin për çdo grup, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al).

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së **30 minuta përpara** orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
  - Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
  - Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
  - Faturën origjinale të pagesës së tarifës së testimit, të kryer për llogari të QSHA-së në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së, [http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fatura\\_specializim.pdf](http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fatura_specializim.pdf))

\* Vëmendje: fatura duhet të ketë vulën e bankës përkatëse.

**Kandidatët, të cilët nuk paraqesin këto dokumente, nuk mund të marrin pjesë në testim.**

2. Kandidati duhet të mbajë parasysh sa më poshtë:
  - Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
  - Ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
  - Ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
  - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit.

Për të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikoni paraprakisht të dhënat në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al) dhe në rast pasaktësish t’i drejtoheni Fakultetit përkatës.

**Në lidhje me orarin e pjesëmarrjes në testim, ju bëjmë me dije se orari do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime përtej planifikimit të publikuar.**

*Ju urojmë Suksese !*